

Cikli i menaxhimit të projekteve

Maj 2018

Çfarë është një projekt?

1. Projekti është një proces i përkohshëm, me një fillim dhe përfundim të përcaktuar qartë, dhe me detyra dhe buxhet që zhvillohen me qëllim të arritjes së qëllimit të përcaktuar qartë apo rezultatit.
2. Projekti është një tërësi e aktiviteteve të njëpasnjëshme që zhvillohen në një vend të caktuar, periudhë të përkohshme kohore, ku këto aktivitete kanë për qëllim të dërgojnë në arritjen e një qëllimi.
3. Projekti është një grup i aktiviteteve të ndërlidhura, brenda një kornize kohore dhe me shpenzime të veta dhe intesitet, të dizajnuara për të arritur një qëllim.
4. Projekti është një ndërmarrje e përkohshme që zhvillohet me qëllim të krijimit të një produkti apo shërbimi unik, ku e 'përkohshme' e ka kuptimin e kohës me fillimin dhe mbarimin e saj. Unike nënkupton që rezultatet e projektit dallojnë nga rezultatet dhe aktivitetet e projekteve tjera brenda organizatës.
5. Një ndërmarrje që përfshin bërjen e një grupi të detyrave apo aktiviteteve me një fillim dhe kohëzgjatje të qartë, dhe me qëllim dhe rezultate të definuara qartë. Secila detyrë, zakonisht e kea qëllimin e vetë të qartë, kohëzgjatje dhe burimet që kërkohen për zbatim.
6. Grup i aktiviteteve të përcaktuara qartë të lidhura me burime dhe produkte, me qëllimin që të arrihet një qëllim apo produkt, në mënyrë që të arrihet ndikimi apo efekti i caktuar në popullatën e targetuar dhe/apo përfituesit.

Përmbledhje:

- Projekti ka fillim dhe mbarim,
- Projekti ka fonde të a project has defined funds,
- Projekti ka zhvillohet përmes metodave të organizuara dhe planifikuara, me qëllim që produktet e saj të kenë një kualitet të caktuar dhe efekt,
- Çdo projekt është unik,
- Projekti ka menxher, që është përgjegjës për rezultatet e saj.

Çka është cikli i menaxhimit të projektit?

Menaxhimi i projektit është një proces i sistemeve të kombinuara, teknikave dhe njohurive me qëllim të kompletimit të një projekti, brenda një afati kohor të caktuar, buxheti dhe madhësie.

Menaxhimi i projektit është një proces i ekipit udhëheqës të njerëzve të kualifikuar përmes procesit të planifikimit dhe zbatimit dhe zbatimit të aktiviteteve përkatëse, që duhet të përfundohen deri në një datë të caktuar, duke përdorur një buxhet të caktuar.

Menaxhimi i projektit është aplikimi i njohurive, aftësive, mjeteve dhe teknikave për aktivitetet e projektit me qëllim të përmbushjes së pritjeve dhe nevojave të palëve të përfshira.

Hapat kryesor në ciklin e menaxhimit të projekteve:



Bazat e shkrimit të projekteve

Konteksti i

Fusha në të cilën synon të zhvillohet/realizohet projekti, duhet të jetë e kufizuar/të detajizohet në mënyrë që konteksti të jetë i qartë, i arritshëm dhe të ketë mundësi për matje të kontributit në arritje të impaktit

projektit:

Impact/Impakti:

Ndryshimi në nivelin më të lartë, pra ndryshimi i përgjithshëm që synohet të arrihet në fushën në të cilën realizohet aktiviteti ynë; ndryshimet që synon t'i sjellë projekti ynë (qëllimi i përgjithshëm)

Outcome/:

Rezultati përfundimtar

Ndryshimi në një nivel më të ulët, një nga masat e konsiderueshme për matjen e kontributit për arritjen e ndryshimit të nivelit më të lartë (qëllimit apo synimit kryesor të projektit)

Output/Rezultati/

produkti:

Produktet apo shërbimet që duhet të realizohen për tu arritur mundësia e ndryshimit në një nivel më të ulët, pra ato janë urë në arritjen e ndryshimit.

Activities/ Aktivitetet:

Detyrat, përkrahja teknike dhe hapat e kërkuar për të arritur rezultatet

Input/Të hyrat/

Investimi:

Burimet e kërkuara për të zbatuar aktivitetet



Objektivi i përgjithshëm (overall objective/outcome)

Objektivi i përgjithshëm është objektivi më i lartë që synohet të arrihet përmes realizimit të këtij projekti, e që shpesh bëhet në kombinim edhe me përpjekje të tjera në sektorin e njëjtë. Zakonisht i referohet programeve apo sektoreve në kontekstin e së cilës do të zhvillohet projekti në fjalë. Shpeshherë, në praktikë, projekte të ndryshme mund të kenë deklarata të ngjashme të objektivës së përgjithshme.

Prandaj, objektiva e përgjithshme zakonisht duhet të shprehet përmes: “*Të kontribuohet në...*”

Objektivat specifike (purpose)

Objektivi specifik/Qëllimi përshkruan efektet e dëshirueshme të projektit, objektivat e menjëhershme/afatshkurtra për përfituesit direkt të projektit, pra gjendja në të cilën dëshirojmë t’i shohim përfituesit tanë në të ardhmen. Objektiva specifike duhet të paraqitet/deklarohet në aspekt të përfitimeve për grupin tonë të synuar.

Ajo duhet të paraqitet si “*përmirësimi/rritja e ...*”.

Pra, objektivi specifik është vetë arsyeja pse po propozohet projekti në fjalë, dhe përshkruan ndikimin që projekti do të sjellë. Pra, mund të përshkruaj se s’i do të ndryshoj gjendja/sjelljen e përfituesve tanë si rrjedhojë e projektit tonë. Zakonisht duhet të ketë një objektiv specifik (varësisht nga madhësia e projektit dhe komponentat që përmbanë edhe më shumë), që bëhet për arsye praktike të zbatimit të projektit, ngase nga përvoja në projekte me fushëveprim më të ngushtë, pasja e më shumë se një objektivë mund të ndikoj në krijimin të konfuzionit dhe si rrjedhojë edhe të dizajnit më të dobët të propozimit.

Megjithëse Qëllimi/Objektivi specifik përshkruan arsyet se pse realizohet projekti, duhet pasur parasysh që kjo është jashtë kontrollit të ekipit të projektit. Ekipi i projektit është përgjegjës për prodhi

min/arritjen e një serie të caktuar të rezultateve mirëpo nuk është përgjegjës se cka do të bëjnë personat apo institucionet me këto rezultatet. Kjo do të thotë që ekipi i projektit duhet të jetë përgjegjës për arritjen e disa rezultateve që kontribuojnë në arritjen e ndikimit/impaktit të dëshiruar, mirëpo nuk mund të mbahet përgjegjës për arritjen e vetë impaktit.

Rezultatet/outputs

Rezultatet janë caqe të cilat ekipi menaxhues i projektit duhet t’i arrijë gjatë kohëzgjatjes së projektit

(pra, CKA duam ne të arrijmë me projektin tonë). Kombinimi i të gjitha rezultateve bashkë duhet të jetë i mjaftueshëm për arritjen e objektivave specifike/të menjëhershme. Ato duhet të shprehn në formë të rezultateve të prekshme/produkteve/arritjeve etj. Ekipi i projektit është drejtpërdrejtë përgjegjës për arritjen e këtyre rezultateve.

Aktivitetet

Aktivitetet shprehen si procese, në kohën e tashme, si për shembull: *“Përgatitja, dizajnimi, ndërtimi, humtimi...”*.

Duhet të shmangët detajizimi i shumtë, pra duhet vetëm të paraqitet struktura bazike dhe strategjia e projektit.

Pra, aktivitetet definojnë se SI do ta zhvillojë projektin ekipi. Përgjithësisht synohet që të tregohet një listë aktivitetesh që duhen zbatuar për të arritur rezultatin.

Duhet ofruar informacione të mjaftueshme që tregojnë strategjinë e arritjes së rezultatit dhe baza për një analizë të punës, ndërsa detajet vendoshen në Planin e Aktiviteteve.

SHËNIM: Rekomandohet që rezultatet dhe aktivitetet të numërohen ashtu që të korrespondojnë me njëri-tjetrin.

SHEMBULL:

Hierarkia e Objektivave	Shembull se s'i të shkruhen
Objektiva e përgjithshme	Të kontribuohet në përmirësimin e shëndetit familjar, vecanërisht të fëmijëve nën moshën 5 vjecare dhe shëndeti i përgjithshëm rreth eko-sistemit të lumenjve
Objektiva specifike/Qëllimi	1. Përmirësimi i kualitetit të ujit të lumit
Rezultatet	1.1. Të ulet volumi i ujërave të zeza që shkarkohet direkt në sistemin e lumenjve nga ekonomitë familjare dhe fabrikat 1.2. Vendosja dhe fuqizimi i standardeve të trajtimit të ujërave të zeza
Aktivitetet	1.1.1. Realizimi i studimit bazë të ekonomive familjare dhe bizneseve 1.1.2. Kompletimi i specifikave të ingjinerisë për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit 1.1.3. Përgatitja e dokumentacionit për tenderim, prokurimi dhe pëzgjedhja e kontraktuesit që do të kryej punët 1.1.4. Identifikimi i faktorëve nxitës që do të ndikonin që bizneset të përdorin teknologji të pastra 1.1.5. Përgatitja dhe zbatimi i kampanjës për informim dhe ndërgjegjësim të publikut të gjerë 1.2.1. etj. 1.2.2. etj.

Verifikimi i Logjikës së Intervenimit përmes testimit me metodën NËSE/ATëHERë (IF/THEN Logic)

Pasi që t'i kemi definuar objektivat e përgjithshme dhe specifike, rezultatet dhe aktivitetet, atëherë preferohet që të testojmë ndërlidhjen logjike në mes tyre përmes ushtrimit/testimit me logjikën

Nëse/Atëherë, si në vijim:

NËSE inputet/burimet e nevojshme janë në dispozicion, ATËHERË aktivitetet do të realizohen;

NËSE aktivitetet realizohen, ATËHERË do të prodhohen rezultatet; ATËHERË qellimi do të realizohet;

NËSE arrihet qellimi, ATËHERË kjo do t'i kontribuojë objektivës së përgjithshme;

Supozimet/Assumptions

Supozimet janë faktorët e jashtëm që kanë potencialin për të ndikuar (apo kanë ndikim përcaktues) në suksesin e projektit, por që janë jashtë kontrollit direkt të ekipit të projektit;

Supozimet në projekte/në Kornizë Logjike i përgjigjen pyetjes “Cilët janë faktorët e jashtëm të cilet ndikojnë në zbatimin e projektit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të përfitimeve, por që janë jashtë kontrollit të menaxhmentit të projektit”?

Për të definuar supozimet duhen marrë parasysh të dhëna dhe informacione nga burime të ndryshme dhe që japin perspektiva të ndryshme (p.sh. ajo që ne e konsiderojmë si supozimin kryesor, për të tjerët mund të mojs jetë i rëndësishëm). Pra, supozimet në masë të madhe edhe janë subjektive, por të dhënat dhe informacionet duhet të merren nga burime të ndryshme.

Indikatorët

Indikatorët janë tregues për amtjen dhe raportimin mbi arritjen e objektivave dhe burimeve të verifikimit të tyre.

Indikatorët janë matës të performancës që na ndihmojnë në njohjen e arritjes së suksesit të objektivave të parapara, dhe në mënyrë të detajuar masin performancën dhe na tregojnë kur duhet të lëvizimin në nivelin tjetër të punës.

Përcaktimi i indikatorëve është mirë të filloj mbrapsht, pra të përcaktohen së pari indikatorët për Objektivën e Përgjithshme, për Objektivat Specifike e pastaj për Rezultatet.

Indikatorët bazohen në premisën “Nëse një punë mund të matet, ajo edhe mund të arrihet”. Prandaj, ata duhet të jenë të specifikuar në aspekt të sasisë, kualitetit, kohës, grupës së synuar dhe vendit.

Kualiteti - lloji apo natyra e ndryshimit (sa mirë)

Sasia - Niveli i ndryshimit (sa shumë)

Kohor - Kur duhet të ndodh ndryshimi (deri kur)

Grupi i synuar - (për kënd)

Vendi - Lokacioni (ku)

Shpeshherë në rastin e objektivës së përgjithshme dhe objektivave specifike nuk vendosen indikatorë, mirëpo preferohet që sa herë që ekziston mundësia, të bëhet kjo, ngase lehtëson matjen dhe raportimin.

Indikatorët mund të jenë kualitativ apo sasior/kuantitativ, dhe duhet të jenë të qartë për të shpjeguar arritjen e kënaqshme të objektivave.

SHEMBULL se s'i të formulohet një indikator:

- ✓ **Objektiva:** Përmirësimi i kualitetit të ujit të lumenjve
- ✓ **Identifiko indikatorin:** p.sh. Koncentrimi i metaleve të rënda dhe ujërat e zeza të patrajuara
- ✓ **Specifiko grupin e synuar:** uji i pijshëm i qasshëm për banorët
- ✓ **Sasia:** niveli i koncentrimit të ulet për 25%
- ✓ **Vendos kualitetin:** të jetë në përputhje me standardet ligjore për kontrollin e shëndetit publik
- ✓ **Specifiko kohën deri kur duhet të arrihet:** në mes viteve 2018-2020
- ✓ **Vendos vendin:** në Ferizaj

Burimet e verifikimit të arritjes së indikatorëve

Burimet apo mënyrat e konfirmimit/verifikimit të arritjes së indikatorëve duhet të merren parasysh dhe definoen bashkë me indikatorët. Ato ndihmojnë në testimin e indikatorëve se sa realist janë në aspekt të kohës, fondeve dhe përpjekjeve që duhen bërë për tu arritur.

Nëse kemi indikatorë për të cilët nuk mund të identifikojmë burime/mënyra të lehta të verifikimit, atëherë ata indikatorë duhet të hiqen dhe zëvendësohen me të tjerë, sepse një indikator nuk është i qëndrueshëm nëse nuk mund ta masim atë.

Burimet e verifikimit duhet të arrijnë të specifikojnë se:

- ✓ **Cfarë** informacione duhet të mbledhen/jenë të qasshme (nga administrata, studi-

met/hulumtimet e ndryshme, pyetësorët, vëzhgimi etj)

- ✓ **Ku dhe si** duhet të mbledhen/dokumentohen burimet (raportet e projektit, financat e projektit, dokumentet zyrtare të statistikave, certifikatat e përfundimit të punës në rast të projekteve ndërtimore etj)
- ✓ **Kush** duhet të mbledh/ofrojë informacione (punëtorët e kontraktuar, ekipet e hulumtimeve, institucionet publike, ekipit menaxhues i projektit);
- ✓ **Kur/Sa** shpesh duhet të ofrohen këto të dhëna (në baza mujore, tre-mujore, vjetore)

Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi i projekteve

Monitorimi nënkupton përcjelljen apo vëzhgimin e vazhdueshëm të zbatimit të projektit ku nuk matet vetëm arritja fizike e zbatimit të projektit (aktiviteteve) por edhe impakti apo ndikimi i projektit dhe zhvillimi në ambientin ku zbatohet (faktorët e jashtëm).

Duhet të ekzistojë vetëm një format i monitorimit dhe raportimit për një projekt gjatë kohëzgjatjes së tij, e që ka për qëllim ofrimin e një baze solide për analizimin e trendeve të ndryshme ku përdoren indikatorët për të matur inputet, aktivitetet, outputet në raport me objektivat specifike dhe atë të përgjithshme për të parë se deri në çfarë niveli është arritur zbatimi. Kjo është edhe baza për hartimin e raporteve të progresit, coftë për raportim te donatori apo për nevoja të brendshme të projektit.

Raportet e progresit dhe monitorimi po ashtu duhet të marrin në konsideratë dhe analizojnë ndryshimet në supozime e që ndikojnë në zbatimin e projektit. Raportet e progresit janë jashtzakonisht të rëndësishme sidomos në rast të ndryshimeve në stafin e projektit.

Monitorimi poashtu shërben për të ofruar udhëzime dhe rekomandime për qasjen dhe strategjinë e projektit dhe për të parë mënyrën më të mirë për të ecur para.

Vlerësimi i projekteve

Shumicën e kohës, vlerësimet janë të pavarura dhe bëhen nga personave apo kompani të kontraktuara nga jashtë ku masin impaktin, relevancën dhe qëndrueshmërinë e projektit. Vlerësimet ka-

në për qëllim të nxjerrin mësim, udhëzojnë dhe të kontrollojnë atë që është arritur gjatë projektit.

Vlerësimet bëhen duke u bazuar në rishikimin e dokumentacionit ekzistues, diskutimet me palët e përfshira dhe studimet e impaktit (nëse ka pasur të tilla).

Vlerësimet mund të jenë vlerësime para fillimit të projektit, vlerësime të ndërmjetme, vlerësime finale dhe post-vlerësime.

Kostimi/Buxheti i shpenzimeve për projekte

Shpenzimet e pranueshme janë shpenzime reale të bëra nga Përfitues(it), që i plotësojnë të gjitha kriteret në vijim:

- a) janë bërë gjatë implementimit të Aktivitetit, siç specifikohet nën 4.1.2. dhe 4.1.3.;
- b) janë paraqitur në buxhetin e përgjithshëm të Aktivitetit;
- c) janë të nevojshme për implementimin e Aktivitetit;
- d) janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, në veçanti të regjistrohen në regjistrat e kontabilitetit të Përfituesit/ve dhe të përcaktuara sipas standardeve të kontabilitetit si dhe të praktikave të zbatueshme të kontabilitetit të kostove që vlejnë për Përfituesin/t;
- e) janë në përputhshmëri të plotë me kriteret e legjislacionit të zbatueshëm social dhe tatimor;
- f) janë të arsyeshme, të arsyetuara dhe janë në përputhshmëri me kërkesat e menaxhimit të drejtë financiar, posaçërisht sa i përket ekonomisë dhe eficiencës.

Llojet e kostove të pranueshme:

- Kostoja e stafit të përcaktuar për Aktivitetin, përfshirë stafin që kryen detyra financiare dhe administrative të lidhura me Aktivitetin, që korrespondon me pagat bruto përfshirë shpenzimet e sigurimit social dhe kostove për kompenzime të tjera; pagat dhe kostot nuk do të tejkalojnë pagat respektivisht kostot që aktualisht i ka Përfituesi/t, përveç nëse mund të dëshmohet se kjo është e nevojshme për realizimin e Aktivitetit;
- Kostot e udhëtimit dhe të jetesës për stafin dhe persona të tjerë që marrin pjesë në Aktivitet, me kusht që ato të mos e tejkalojnë shumën e atyre që aktualisht i ka Përfituesi/t, sipas rregullave, apo të normave të publikuara nga Komisioni Evropian në kohën e një misioni të tillë, nëse kompenzohen në bazë opsioneve për kosto të thjeshtëzuar;
- Kostot e blerjes për pajisje dhe furnizime të blera enkas për qëllime të Aktivitetit, me kusht që pronësia të transferohet në fund të Aktivitetit;
- Kostoja e gjërave të konsumueshme;
- Kostoja e ngarkesave bankare;
- Kostot e dala nga kontratat që jepen nga Përfituesi/t për qëllime të Aktivitetit;
- Kostot që derivojnë drejtpërdrejtë nga kërkesat e Kontratës (shpërndarja e informatave,

vlerësim enkas për Aktivitetin, kontabiliteti, auditim, përkthime, riprodhim, sigurim, etj.)

Kostot indirekte

Të bëra përgjatë realizimit të aktivitetit mund të jenë të pranueshme për kompensim me tarifë fikse, por totali nuk guxon ta tejkalojë 7% të shumës së përgjithshme të kostove të pranueshme të drejtpërdrejta. Kostot indirekte janë të pranueshme me kusht që ato të mos përfshijnë kosto që i përkasin një kategorie tjetër buxhetore në kontratën standarde të grantit. Aplikuesi kryesor duhet t'i arsyetoj në detaje kostot indirekte në formularin e plotë të aplikimit (në formularin e arsyetimit të buxhetit). Megjithatë, në momentin kur të përcaktohet tarifa fikse në Kushtet e Veçanta të kontratës së grantit, nuk ka nevojë për dokumente mbështetëse shtesë.

Kostot e papranueshme

Kostot në vijim janë ta papranueshme:

- tatimet, përfshirë tatimet mbi vlerën e shtuar (TVSH)
- ngarkesat doganore dhe të importit, apo kosto të tjera;
- blerja, qirmarrja apo lizingu i tokës apo ndërtesave ekzistuese;
- gjobat, dënimet financiare apo shpenzime gjyqësore;
- kosto indirekte operationale, kostot të garancive apo të ngjashme;
- kostot e konvertimit, ngarkesat apo humbjet e këmbimeve në cilëndo prej llogarive në euro, si dhe shpenzime të tjera ekskluzivisht financiare;
- çfarëdo shpenzimi për lizing;
- kostot e amortizimit;
- borxhet dhe ngarkesat e borxheve;
- provizione për humbje apo detyrimeve potenciale në të ardhmen;
- kamata të detyruara;
- kosto të deklaruar nga Përfituesi dhe që mbulohen nga ndonjë aktivite

ANNEX 1. TEMPLATE I LOGFRAME

Përshkrimi i projektit	Indikatorët e performancës	Burimet e verifikimit	Supozimet
Qëllimi i përgjithshëm: Impakti i përgjithshëm që projekti mëton të arrijë në sektorin e caktuar	Masin kontributin e projektit në arritjen e qëllimit të përgjithshëm, për qëllime të vlerësimit	Burimet e të dhënave dhe metodat për mbledhjen e tyre	
Objektiva specifike: Ndikimi i pritshëm që mëton të arrijë specifikisht projekti ynë përmes outputve/rezultateve të parapara	Përcakton nëse qëllimi i projektit është arritur, dhe nëse rezultatet janë të qëndrueshme	Burimet e të dhënave dhe metodat për mbledhjen e tyre	Faktorët jashtë kontrollës së menaxhmentit të projektit e që mund të ndikojnë në realizimin e qëllimit të përgjithshëm
Outputet/Rezultatet: Rezultatet direkteve (shërbimet apo mallrat) që do të maten nga projekti	Masin sasinë, kualitetin dhe kohën e outputeve, për qëllime të monitorimit dhe rishikimit	Burimet e të dhënave dhe metodat për mbledhjen e tyre	
Aktivitetet: Veprimet që do t'i ndë marrë projekti për arritjen e rezultateve	Masin caqet projektit; për qëllime të monitorimit	Burimet e të dhënave dhe metodat për mbledhjen e tyre	

ANNEX II – Template i Kornizës Logjike të BE

	Zingjiri i rezultateve	Indikatorët	Gjendja aktuale (përfshij. Vitin e referencuar)	Vlera aktuale Datat e referencës	Tar- getet/Caq et (përfshij. Vitin e referen- cuar)	Burimet dhe mënyrat e veri- fikimit	Supozimet
Objektiva e përgjithshme: Impakti	Ndryshimi i përgjithshëm dhe afatgjatë që do të rezultoj nga projekti si dhe intervenimet/projektet e partnerëve të tjerë.	Masni ndryshimit afatgjatë të cilit do t'i kontribuojë projekti. Të dhënat të paraqiten sipas ndarjes së bazuar në gjini.	Idealisht, të merret nga strategjia e partnerit		Idealisht, të merret nga strategjia e partnerit	Të merret nga strategjia e partnerit	
Objektivat specifike:	Efektet direkte të projektit që do të arrihen në kohë afat-mesme dhe që duhet të fokusohen në ndryshimet në sjellje që vijnë si rrjedhojë e vetë projektit	Masni ndryshimin e faktorëve që përcaktojnë ndryshimin. Të dhënat të paraqiten sipas ndarjes së bazuar në gjini.	Pika fillestare apo aktuale e indikatorëve	Vlera e indikatorëve në kohën e përcaktuar	Vlera e dëshiruar e indikatorëve	Burimet e informacioneve dhe metodat për mbledhjen e tyre dhe raportimin. (duke përfshirë nga kush dhe sa shpesh).	Faktorët jashtë kontrollës së menaxhmentit të projektit e që mund të ndikojnë në realizimin e qëllimit të përgjithshëm
Outputet	Outputet direkte/të matshme (infrastrukturë, shërbime dhe mallra) që do të realizohen nga projekti. by the project.	Masni nivelin e arritjes së outputeve. Të dhënat të paraqiten si-	Si më lartë.		Si më lartë.	Si më lartë.	Faktorët jashtë kontrollës së menaxhmentit të projektit e që mund të ndikojnë në

	Outputet = Op Op 1.1. (ndërlidhen me Oc 1) (...) Op 2.1. (ndërlidhen me Oc 2) (...)	pas ndarjes së bazuar në gjini					realizimin e qëllimit të përgjithshëm
Aktivitetet	<i>Cilat janë aktivitetet që do të realizohen nga projekti, për të prodhuar rezultatet/outputet (mund t'i gruponi aktivitetet dhe t'i numëroni si në vijim:</i> <i>A 1.1.1. – "Titulli i aktivitetet "</i> (...)	Burimet: <i>Cilat burime duhen për zbatimin e aktiviteteve, p.sh. staf, pajisjet, trajnimet, studimet, hapësira etj.</i> Shpenzimet <i>Cilat janë shpenzimet e projektit? Si klasifikohen ato? (Detajet vendosen në buxhet)</i>					<i>Faktorët jashtë kontrollës së menaxhmentit të projektit e që mund të ndikojnë në realizimin e qëllimit të përgjithshëm</i>

ANNEX III – Template i Kornizës Logjike të BE – e plotësuar me një shembull

	Zingjiri i rezultateve	Indikatorët	Gjendja aktuale (përfshij. Vitin e referencuar)	Vlera aktuale Datat e referencës	Targetet/Caqet (përfshij. Vitin e referencuar)	Burimet dhe mënyrat e verifikimit	Supozimet
Objektiva e përgjithshme: Impakti	<i>Të kontribuohet në fuqizimin e sektorit të mediave në Kosovë për të përmbushur rolin e vetë në sistemin demokratik duke shërbyer si ndërmjetës të pavarur, monitoruar institucionet publike dhe kontribuar në ngritjen e llogaridhënies dhe transparencës në proceset demokratike.</i>	1. Rritja e njohurive të rreth 50 gazetarëve, 50 studentëve të gazetarisë dhe rreth 50 shtëpive mediale/organizatave në gazetari humltuese dhe raportim të interest publik.	1. Gazetarët në Kosovë kanë mungesë të njohurive për gazetari humltuese dhe mungesë të aftësive analitike për humltime të thella;	Maj 2018	Deri në vitin 2019, mediat lokale dhe organizatat do të rrisin njohuritë e tyre për raportim kualitativ dhe humltues për 30%.	Listat e pjesëmarrësve; Linqet e raporteve humltuese/analitike të prodhuara dhe publikuara/transmetuara;	Shoqëria civile, mediat dhe individët që punojnë në fushën e mediave janë të interesuar dhe kanë vullnet të zhvillojnë aftësitë e tyre për të prodhuar gazetari humltuese të nivelit të lartë.

